



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agjencija za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture
Development Agency**

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për kulturat bujqësore (grurë, misër, luledielli dhe farë gruri) për vitin 2014

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të vazhdojë të mbështesë sektorin e drithërave përmes pagesave direkte për njësi të sipërfaqes së mbjellë me kulturën e grurit, farës për grurë, misrit dhe lulediellit. Niveli i mbështetjes do të jetë:

- Pagesa Direkte - Grurë 125 €/ha
- Pagesa Direkte - Farë gruri 225 €/ha
- Pagesa Direkte - Misër: 100 €/ha
- Pagesa Direkte - Luledielli 100 €/ha

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku 2 ha tokë me grurë;
- Të kenë të mbjellë së paku 1 ha tokë me misër në pronësi;
- Të kenë të mbjellë së paku 1 ha tokë me luledielli në pronësi;
- Të kenë të mbjellë minimum 5 ha dhe maksimum 100 ha tokë me grurë për prodhimin e farës së grurit;
- Parcela e mbjellë me grurë, misër ose luledielli, duhet të jetë në minimum 0.20 ha e pandarë;

- Parcela e mbjellë me grurë për prodhimin e farës së grurit, duhet të jetë në minimum 1 ha e pandarë;
- Fara e mbjellur e grurit duhet të jetë në Listën e Lejuar të Farës (vetëm për fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri);
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qera duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qera duhet të jetë 1 ha e pandarë;
- Sipërfaqet e mbjella me grurë për farë duhen plotësuar kriteret gjatë inspektimit fushor (vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Dëshminë nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi (fletën poseduese);
- Kontrata për sipërfaqen e marrë me qera, duke bashkëngjitur fletën poseduese të qeradhënësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- Dëshminë mbi kategorinë e farës së mbjellur për farë gruri (vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri);
- Kontratën me kompaninë prodhuese të farës (vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri);
- Formularin për sipërfaqet e mbjellura me farë gruri (e verifikuar nga MBPZHR-ja, vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri);
- Raportin e Inspektoratit Fitosanitar nga inspektimet fushore I dhe II (vetëm fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri);
- Dëshminë për sasinë e grurit të dorëzuar kompanisë prodhuese të farës (t'i bashkëngjitet dokumentacionit pas korrjes së grurit dhe vlen vetëm për fermerët që aplikojnë për pagesa direkte për farë gruri).

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 45 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes së thirrjes për aplikim. Aplikimi bëhet në Zyrrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi përmes programit sLPIS.

Mënyra e aplikimit:

- Të gjithë fermerët fillimisht gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.
- Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MBPZHR Nr.02/2014 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2014.

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim;
- Fermerët përfitues për pagesat direkte për farë të grurit do të paguhen vetëm për sipërfaqet e pranura për farë të grurit dhe dëshmisë mbi sasinë e dorëzuar të farës së grurit bazuar në rendimentin mesatar të grurit për vitin aktual.